

---

**THE RIGHT TO A FAIR TRIAL AND AT A REASONABLE TIME**

---

**Havsa Musliu**Saints Cyril and Methodius University of Skopje, Republic of Macedonia [havsamusliu@gmail.com](mailto:havsamusliu@gmail.com)

**Abstract:** This paper contains the following segments: theoretical explanations for the defendant's rights in criminal proceedings, the purposes of the defendant's rights, the role of courts, public prosecutors and police and their obligation to respect the rules of the Criminal Code and Criminal Procedure Law and the rights provided by these acts. Furthermore, in general we will talk about the defendants rights especially about the right to a fair trial and at a reasonable time and how respected is this right in Republic of Macedonia. A person charged with a criminal offense has the right to a fair and public trial, within a reasonable time, before a competent, independent and impartial court established by law. The meaning of a reasonable timeframe has therefore been made to ensure that within a reasonable time and by a court decision ending the uncertainty that a person has in terms of his / her position in terms of a criminal charge against him / her: this is in the interest of the defendant as well as legal security. Among other things, will be discussed also that procedural requirements for a fair trial and in a reasonable time are accompanied by a requirement for procedural economy. However, the procedural economy, however important, must not be reflected in the detriment of finding the truth in criminal proceedings.

**Keywords:** courts, judges, efficiency, reasonable time, corruption, politics.

**E DREJTA NË GJYKIM TE DREJTË DHE NË KOHË TË ARSYESHME****Havsa Musliu, PhD student**

Universiteti Shën Kirili dhe Metodij në Shkup, Republika e Maqedonisë

[havsamusliu@gmail.com](mailto:havsamusliu@gmail.com)

**Abstract:** Ky punim përmban këto segmente: shpjegime teorike për të drejtat e të pandehurit në procedurë penale, qëllimet e të drejtave të të pandehurit, roli i gjykatësve, prokurorit publike dhe policies dhe detyrimin e tyre për respektimin e rregullave të Kodit Penal dhe Ligjit të Procedurës Penale dhe të drejtat e parashikuara nga këto akte. Në përgjithësi do të flasim për të drejtat e të pandehurve, veçanërisht për të drejtën për një gjykim të drejtë dhe në një kohë të arsyeshme dhe sa respektohet kjo e drejtë në Republikën e Maqedonisë. Personi i akuzuar për veprë penale ka të drejtë në një gjykim të drejtë dhe publik, brenda një kohe të arsyeshme, përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj. Në procedurën penale garancia për gjykim në afat të arsyeshëm ka për qëllim që personi i akuzuar për veprë penale të mos vëhet në situatë që një kohë shumë të gjatë në gjendje pasigurie për fatin e vet ose t'u nënshtrohet një varg privimesh lidhur me zhvillimin e procedurës penale kundër tij. Kërkesave procedurale për gjykim të drejtë dhe në afat të arsyeshëm u bashkangjitet edhe kërkesa për ekonomicitetin procedural. Megjithatë, ekonomiciteti procedural sado i rëndësishëm, nuk guxon të reflektohet në dëm të gjetjes së të vërtetës në procedurë penale.

**Fjalët kyçe:** gjykatat, gjyqtarët, efikasiteti, koha e arsyeshme, korrupsioni, politika.

Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i garanton çdokujt një seancë Brenda një afati kohor të arsyeshëm. Gjykata ka deklaruar se qëllimi i këtij garantimi është që të mbrojtë “të gjitha palët në procesin gjyqësor...kundrejt vonesave të gjata procedurale”. Ky garantim më tej “thekson rëndësinë e dhënies së gjykimit pa vonesë që mund të vërë në rrezik efikasitetin dhe besueshmërinë”<sup>470</sup>. Kuptimi i kushtit të afatit kohor të arsyeshëm është bërë si rrjedhim për të garantuar që brenda një afati kohor të arsyeshëm dhe me anë të një vendimi gjyqësor t'i jepet fund pasigurisë që ka një person përse i përket pozitës së tij /saj përse i përket një akuze penale kundër tij /saj: kjo është në interes të personit në fjalë si dhe të sigurisë ligjore.

---

<sup>470</sup> Asocijacija za evropske integracije (Association for European Integration), “Putokaz” nr. 5, Tema broja – Konvencija o Ljudskim Pravima i Srbija, Septembar / 2007, ISSN 1452-5348, fq. 10, Të dhëna nga interneti: <http://www.fes.rs/pubs/2007/pdf/6.Putokaz%20-%20Konvencija%20o%20ljudskim%20pravima%20i%20Srbija.pdf>. Zbritur më: 09.09.2011.

Koha që llogaritet në afatin e arsyeshëm në procedure penale fillon prej momentit kur personi privohet nga liria, që mund të jetë edhe para sjelljes së vendimit formal për përcaktimin e paraburgimit, kurse mbaron me sjelljen e aktgjykimit përfundimtarë ose kur personi lirohet<sup>471</sup>.

Gjykata ka përcaktuar në precedentin e saj se kur bëhet vlerësimi nëse kohëzgjatja mund të konsiderohet e arsyeshme, faktorët e mëposhtëm duhen marrë parasysh: kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuesit, sjellja e autoriteteve gjyqësore dhe administrative të shtetit dhe për çfarë të drejte bëhet fjalë<sup>472</sup>.

Gjykata ka parasysh rrethanat e veçanta të çështjes dhe nuk ka caktuar një afat përfundimtar kohor. Në disa raste Gjykata bën më shumë një vlerësim të përgjithshëm sesa t'i referohet drejtpërdrejtë kriterit të mësipërm<sup>473</sup>.

Kushtetuta dhe ligjet sigurojnë një gjyqësor të pavarur, megjithatë, Qeveria, presioni politik, kërcënimet, korrupsioni kanë ndikuar në sistemin e gjyqësorit. Financimet joadekuate të gjyqësorit vazhdojnë të pengojnë operacionet e gjykatës dhe efektivitetin. Një numër i zyrtarëve gjyqësore kanë akuzuar qeverinë për përdorimin e autoritetit të saj buxhetor për të ushtruar kontroll mbi gjyqësorin. Pavarësisht kësaj, Qeveria përsëri ka reduktuar buxhetin vjetor gjatë vitit.

Më 28 tetor, parlamenti ndryshoi ligjin për të rregulluar buxhetin e gjykatës në një minimum prej 0.8 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), duke adresuar nevojën për fonde të mjaftueshme dhe të qëndrueshme të gjykatave. Megjithatë, ligji i ri duhet të zbatohet gradualisht në fillim të vitit 2012 dhe nuk do të arrijnë nivelin e 0,8 për qind deri në vitin 2015.

Presioni politik ka ndikuar edhe në punën e Këshillit Gjyqësor, organin përgjegjës për zgjedhjet, disiplinën, dhe shkarkimin e gjyqtarëve.

Në janar OSBE-ja ka publikuar rezultatet e një ankete anonime të gjyqtarëve, në të cilën dy të tretat e gjyqtarëve 650 të vendit ka marrë pjesë. Rezultatet treguan se shumica e të intervistuarve mendonin presion nga partitë politike dhe qeverinë në marrjen e vendimeve, dhe 43 për qind deklaruan se ky presion ka ndikuar vendimet e tyre<sup>474</sup>.

Një nga detyrat kryesore të cilat i janë dhënë Republikës së Maqedonisë në procesin e intergimeve euro-atlantike është përforcimi i pavarësisë gjyqësore. Opinion publik në Maqedoni lidhur me pavarësinë e gjykatësve është kryesisht negativ. Vetë gjykatësit nuk kanë bërë shumë për të fituar pushtet të vërtetë. Pushteti ekzekutiv dhe ai legjislativ poashtu nuk bënë shumë për të dhënë një shans të tillë gjykatësve. “Memorja kolektive e sistemit socialist” dhe roli i gjyqësisë në atë kohë akoma është prezente. Pasojat e kësaj periudhe, kur drejtësia ishte nënshtruar politikës, akoma janë prezente, veçanërisht në administratë dhe gjyqësi, roli i të cilëve në rendin juridik dhe shoqëri akoma nënçmohet. Në Republikën e Maqedonisë janë bërë shumë ndryshime kushtetuese në mënyrën e emërimit dhe shkarkimit të gjykatësve dhe në përbërjen e Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, me qëllim që të krijohen garanca strukturore për pavarësinë e gjyqësisë. Mirëpo, nga njëra anë parashtrohet pyetja sa këto ndryshime kushtetuese janë hap i vërtetë drejt realizimit të pavarësisë gjyqësore. Nga ana tjetër imponohet sentimentit se realizimi i reformave gjyqësore të cilat kanë të bëjnë me garancat institucionale të pavarësisë gjyqësore janë hapi i parë por i pamjaftueshëm për arritjen e pavarësisë gjyqësore. Ndërtimi i shtetit juridik dhe vënia e sistemit të sundimit të së drejtës është shumë më me rëndësi për realizimin e pavarësisë gjyqësore, ndërsa për realizimin e këtij objekti është i rëndësishëm kontributi i pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv, mirëpo edhe i pushtetit gjyqësor.

Kërkesave procedurale për gjykim të drejtë dhe në afat të arsyeshëm u bashkangjitet edhe kërkesa për ekonomikitetin procedural. Megjithatë, ekonomikiteti procedural sado i rëndësishëm, nuk guxon të reflektohet në dëm të gjetjes së të vërtetës në procedurë penale<sup>475</sup>.

E drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm është një ndër parimet më të rëndësishme dhe e drejtë themelore procedurale e njeriut e garantuar me Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

<sup>471</sup> Ibid.

<sup>472</sup> Ibid.

<sup>473</sup> Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut. Këshilli i Evropës F-67075, Strasbourg Cedex, E drejta për një proces të drejtë gjyqësor, Një udhëzues për implementimin e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Nuala Mole dhe Catharina Harby, Të dhëna nga interneti: <http://www.humanrights.coe.int>. Zbritur më: 05.09.2011.

<sup>474</sup> SHBA–Kritika për të drejtat e njeriut në Maqedoni. [albanur.net/forum](http://albanur.net/forum), Të dhëna nga internet: <http://albanur.net/forum/showthread.php?p=2400>. Zbritur më: 07.09.2011.

<sup>475</sup> Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2007, fq. 41;

Konventa parasheh që “çdokush ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe publik brenda afatit të arsyeshëm, para gjykatave të pavarura dhe të paanshme të krijuara në bazë të ligjit”<sup>476</sup>.

Në procedurën penale garancia për gjykim në afat të arsyeshëm ka për qëllim që personi i akuzuar për veprë penale të mos vëhet në situatë që një kohë shumë të gjatë në gjendje pasigurie për fatin e vet ose t'u nënshtrohet një varg privimesh lidhur me zhvillimin e procedurës penale kundër tij. Veprimi i shpejtë do të duhej t'ia mbrojtë të drejtën e të akuzuarit për mbrojtje efikase, meqenëse kalimi i kohës mund të rezultojë me humbjen e dëshmimeve në favor të mbrojtjes, kurse objektiviteti i aktgjykimit, i sjellur për një kohë më të gjatë pas kryerjes së veprës, bëhet temë konraverzesh me çka gëryhet zvogëlohet besimi i opinionit në legjislativën penale.

Periudha që është duke u shqyrtuar përfshin tërë procedurën penale. Praktika Evropiane zbaton një qasje fleksibile. Si relevant e merr stadiumin kur pozita e personit është dukshëm e ndjeshme, si pasojë e dyshimeve kundër tij. Parimin e njëjtë të përgjithshëm që ka të bëjë me fillimin e periudhës relevante, organet në Strazburg e zbatojnë edhe në viset e veta. Në këtë kuptim periudha e shqyrtuar zgjat përderia pozita e personit nuk pushon të jetë e ndjeshme si rezultat i akuzës së ngritur kundër tij. Prandaj, periudha që shqyrtohet e mbulon tërë procedurën penale, përfshirë edhe procedurën rreth mjeteve juridike.

Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës nuk ekzaminohet in abstracto, por në dritën e rrethanave të veçanta të rastit. Nga ana tjetër kalimi i afateve për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara rreth proceseve të parapara me ligjet e vendit, nuk ka rëndësi më të madhe gjatë vlerësimit se a është plotësuar kërkesa nga neni 6 (1) të Konventës Evropiane.

Me ratifikimin e Konventës janë krijuar kushtet që edhe qytetarët e Republikës së Maqedonisë, të cilët konsiderojnë se u është shkelur e drejta e gjykimin brenda afatit të arsyeshëm, të mund të parashtrajnë padi në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. E drejta e gjykimin brenda afatit të arsyeshëm është përmbajtur edhe në Ligjin mbi gjykatat të Republikës së Maqedonisë, në të cilin thuhet se: “gjatë vendosjes për të drejtat dhe obligimet civile, si dhe gjatë vendosjes për përgjegjësi penale, secili ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe publik brenda afatit të arsyeshëm, para gjykatës së pavarur dhe të paanshme, të themeluar në bazë të ligjit”<sup>477</sup>. Po t'i referohemi dispozitës së lartpërmendur do të mund të konstatojmë se e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm mbron në mënyrë të njëjtë të drejtat në procedurë civile dhe të drejtat në procedurë penale.

Mirëpo, kjo rregull në praktikë nuk zbatohet në nivel të duhur. Gjykimi brenda afatit të arsyeshëm është edhe pjesë e planit strategjik të Ministrisë së drejtësisë së Republikës së Maqedonisë, për periudhën 2008-2010, i cili ka për qëllim plotësimin e kushteve të cilat duhet të përmbushen në rrugën e Republikës së Maqedonisë drejt familjes evropiane, respektivisht, realizimin e prioritetëve që lidhen me krijimin e një sistemi efikas, të pavarur dhe profesional gjyqësor, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, rritjen e efikasitetit të punës së gjykatës etj.

Me anë të rregullave që kanë të bëjnë me të drejtën e gjykimin brenda afatit të arsyeshëm nga gjyqtari kërkohet drejtësi ligjore dhe efikase. Drejtësia ligjore ka kuptimin e verifikimit të fakteve relevante dhe zbatimit të drejtë të normave procedurale dhe materiale, ndërkohë që drejtësia efikase synon që këto qëllime të ligjshmërisë të arrihen në afat sa më të shkurtër, në mënyrë që subjekti që kërkon të drejtën dhe mbrojtjen juridike, ta fitojë atë sa më parë<sup>478</sup>.

Ekzistojnë mendime se gjykimi brenda afatit të arsyeshëm, respektivisht përcaktimi i afateve strikte mund të ndikojë negativisht në pavarësinë e gjyqtarit i cili planifikon kohën e gjykimin. Megjithatë, duket më i pranueshëm mendimi, sipas të cilit gjyqtari vazhdon të jetë krejtësisht i pavarur në sjelljen e vendimit, edhe pse atë duhet ta sjell brenda një afati të caktuar saktë.

Në Republikën e Maqedonisë, ligdhënësia deri më tani nuk ka praktikuar përcaktimin e saktë të kohës së gjykimin. Megjithatë, mendoj se në sistemin tonë gjyqësor, ashtu sikurse, edhe në sistemet gjyqësore të botës së civilizuar, duhet respektohet standardi juridik “gjykim brenda afatit të arsyeshëm”, por, përmasat e këtij standardi duhet të përcaktohen duke pasur parasysh situatën konkrete në gjyqësinë tonë: kemi një numër të madh të lëndëve të pazgjydhura, edhe pse kemi numër të mjaftueshëm gjyqtarësh; kemi pengesa strukturale në shoqëri dhe aparat gjyqësor, të cilat gjenerojnë paraqitjen e një numri të madh të lëndëve të mbetura, të cilat pengojnë punën në lëndët

<sup>476</sup> Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore – 4 nëntor 1950. E miratuar më 4 nëntor 1959 në Romë. Konventa ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1953, neni 6 parag. 1.

<sup>477</sup> Ligji mbi gjykatat, “Gazeta zyrtare e RM” nr. 58/2006 dhe 35/2008, neni 6 parag. 2.

<sup>478</sup> Radolović, Aldo, Zaštita prava na suđenju u razumnom roku – Realna mogućnost, (pre)skupa avantura ili utopija, UDK: 342.722, Ur.: 17. siječnja 2008, Pr.: 31. siječnja 2008, Pregledni znanstveni članak, fq. 282, Të dhëna nga interneti: [http://www.pravri.hr/hr/zbornik/v29\\_1/radolovic-29-1-2008.pdf](http://www.pravri.hr/hr/zbornik/v29_1/radolovic-29-1-2008.pdf). Zbritur më 08.09.2011.

e tjera; gjyqtarët tanë nuk kanë kushte të volitshme për punë; mungon niveli i kulturës juridike të pjesëmarrësve të tjerë në gjykim; shteti harxhon shuma të mëdha të hollave në emër të kompensimit për shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Nëse këto mjete do t'i harxhonte për avancimin e kuadrove, rinovimin e objekteve gjyqësore, rregullimin e hapësirave nëpër gjykata, kompjuterizimin e tyre etj., nuk do të kishim këtë situatë që e kemi.

Duke pasur parasysh situatën aktuale që ekziston në Republikën e Maqedonisë, duhet të përcaktojmë afate më të gjata, të cilat do të mund t'i respektonim, edhe atë sipas formulës: një vit (1 vit) për procedurën në shkallë të parë; nëntë (9) muaj për procedurën në shkallë të dytë; gjashtë (6) muaj për revision (rishqyrtim (pa pezullimin e ekzekutimit)).

Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore është një nga problemet më të vështira të gjyqësisë në Republikën e Maqedonisë, prandaj edhe mbrojtja e të drejtës në gjykim brenda afatit të arsyeshëm, për momentin, është një nga çështjet më të rëndësishme juridike dhe politike.

E drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nuk është garantuar në mënyrë eksplicite me Kushtetutë. Megjithatë, ky parim obligon drejtpërdrejt Republikën e Maqedonisë, sepse sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, "Marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar në pajtim me Kushtetutën janë pjesë e rendit juridik të brendshëm dhe nuk mund të ndryshohen me ligj"<sup>479</sup>.

Instituti i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm është rregulluar me dispozitat e Ligjit mbi gjykatat (2006), respektivisht, në mënyrë më detale me dispozitat e Ligjit me ndryshime dhe plotësime të Ligjit mbi gjykatat (2008). Në Ligjin mbi gjykatat, çështja e mbrojtjes së të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm numërohet si një nga kompetencat e Gjykatës Supreme<sup>480</sup>, ndërkohë që, shqyrtohet edhe e drejta e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, edhe atë: "pala e cila konsideron se gjykata kompetente ka shkelur parimin e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka të drejtë të parashtojë kërkesë për mbrojtjen e kësaj të drejte, drejtuar Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, e cila është e obliguar që brenda afatit prej gjashtë muajsh nga parashtrimi i kërkesës, të vendosë nëse gjykata më e ulët ka shkelur të drejtën në fjalë. Nëse vërtetohet shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm me vendim përkatës do të caktojë kompensim (i cili bie mbi buxhetin e gjykatës) për palën që ka parashtruar kërkesën"<sup>481</sup>, ky kompensim në të holla tangon buxhetin e gjykatës, dhe duhet të paguhet në afat prej tre muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit të Gjykatës Supreme.

Gjatë procesit të vendosjes për shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, në rastet penale merren parasysh posaçërisht: 1) Kompleksiviteti i rastit (Natyra dhe numri i aktakuzave) në tërësi (si çështje faktike ashtu edhe juridike), 2) Sjellja e të akuzuarit, 3) Mënyra se si është zhvilluar rasti nga autoritetet kompetente nacionale dhe 4) Për çfarë të drejte bëhet fjalë. Asnjë prej këtyre elementeve, me këtë rast, nuk është vetëvetiu vendimtar, por të gjithë konsiderohen si faktorë që do të mund ta sqaronin kohëzgjatjen e tepërt të procedurës penale në rastin konkret. Në këtë kuptim, çdonjëri prej tyre ekzaminohet në mënyrë veçmas dhe vlerësohet kontributi i tyre për kohëzgjatjen e procedurës. Në fund, duke i përmbledhur të gjithë faktorët relevant bashkë, vlerësohet se vallë periudha e ekzaminuar mund të llogaritet si e arsyeshme. Gjykata për të Drejtat e Njeriut ka një mirëkuptim dhe tolerancë përderisa autoritetet nacionale merren me rastin por, posaçërisht në mënyrë negative shihen periudhat e gjata të joaktivitetit.

Ligji për procedurë penale vendor nuk e shtron problemin e punës ekspeditive si e drejtë e të akuzuarit, por si obligim ndaj subjekteve procesuese. Këtu, "gjykata është e detyruar që të bëjë përpjekje që procedura të zbatohet pa zhagjitje të gjatë dhe të pengohet çdo lloj keqpërdorimi të të drejtave që (u) takojnë personave që marrin pjesë në procedurë"<sup>482</sup>. Formulimi i këtillë në njëfarë mënyre sikur e relativizon përgjegjësinë e gjykatës, duke i obliguar më shumë subjektet e tjera se sa vetë gjykatën. Obligimi kryesor i Ligjit për procedurë penale ka të bëjë me sferën e veprimit të lirë të gjykatës jashtë afateve të caktuara me norma të veçanta. Ai do të duhej ta shtynte gjykatën që të ketë një vetëdisiplinë gjatë udhëheqjes së procedurës pa digresione të panevojshme dhe disiplinimin e pjesëmarrësve të tjerë në përputhje me rregullat e procedurës. Shumë norma të tjera kanë për qëllim shpejtimin e procedurës (për shembull: procedura e shkurtuar, shkurtimi i së drejtës për përjashtim për shkak të dyshimit në anësinë e gjykatësit

<sup>479</sup> Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (teksti jozyrtarë, i spastruar – për përdorim intern), Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL), përktheu, përshtati dhe redaktoi Kurtesh Saliu, Tetovë, 2007, neni 118, parag. 1.

<sup>480</sup> Ligji mbi gjykatat, "Gazeta zyrtare e RM" nr. 58/2006 dhe 35/2008, neni 35, parag.1 pika 6.

<sup>481</sup> Ligji mbi gjykatat, "Gazeta zyrtare e RM" nr. 58/2006 dhe 35/2008, neni 36.

<sup>482</sup> Ligji për procedurë penale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.15, 07.03.2005, Tekst i spastruar, neni 13.

ose të gjykatësit porotë, në fillimin e shqyrtimit kryesor, mundësia që Prokurori të disponojë me aktakuzën edhe në procedurën e shkallës së dytë, mundësia e shkurtimeve të afatit në mes të dorëzimit të thirrjes dhe shqyrtimit kryesor me pëlqimin e të akuzuarit, pamundësia e ankesës kundër akuzës së ngritur në shqyrtimin kryesor etj.).

Duhet pasur parasysh edhe atë se kohëzgjatja e procedurave në masë të madhe varet nga organizimi dhe pajisja kadrovike dhe teknike e gjyqësisë.

Në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë nuk ekziston një mjet juridik efikas lidhur me ankesat ndaj shkeljes së të drejtës së gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, kjo është edhe arsyeja kryesore që ndikon në numrin e madh të ankesave të qytetarëve të saj para Gjykatës Evropiane. Të dhënat statistikore të Gjykatës Evropiane tregojnë se (5) ankesat e para kundër Republikës së Maqedonisë nga ana e qytetarëve të saj u paraqitën menjëherë në vitin 1998, dhe vazhduan me një tendencë rritjeje marramendëse. Kështu, në vitin 1999 u paraqitën (31) ankesa, në vitin 2000 (41), në vitin 2001 (59), në vitin 2002 (95), në vitin 2003 (148), në vitin 2004 (148), në vitin 2005 (234), në vitin 2006 (343), në vitin 2007 (454) dhe në vitin 2008 (395)<sup>483</sup>.

Tanimë është konsumuar e drejta që si arsyetim për mosefikasitetin e punës së gjykatave të theksohet: organizimi i joefikas i sistemit gjyqësor vendas, numri i gjyqtarëve nëpër gjykata, zgjidhjet joadekuate dhe të vjetruara, mungesa e mjeteve materiale, etj. Në këtë drejtim, nga viti 2005 e këndeje janë marrë masa me qëllim të ndryshimit të kornizës ligjore procedurale.

Gjykata Evropiane ka konstatuar se gjykimi brenda afatit të arsyeshëm edhe më tej mbetet baza më e shpeshtë për shkeljen e të cilës qytetarët e Republikës së Maqedonisë ankohen para Gjykatës Evropiane. Në lidhje me këtë janë evidentuar disa hapa në drejtim të përmirësimit të situatës. Ligji mbi ndryshime dhe plotësime të Ligjit mbi gjykatat, i cili më për së afërmi iu referua procedurës para Gjykatës Supreme, (për dallim nga paraardhësi i vet i cili u vlerësua si jofunksional) arriti të operacionalizojë mjetin juridik me të cilin palët mund të kërkojnë mbrojtje juridike të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm drejtëpërdrejtë para gjykatave të vendit. Gjithnjë në mbështetje të ligjit në fjalë, rregullave dhe parimeve të Konventës Evropiane si dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata Supreme filloi të procedojë kërkesat e palëve të cilat kërkonin mbrojtje të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Në fillim të vitit 2009 Gjykata Supreme solli vendime meritore, me të cilat vlerësoi zvarritjen e procedurave gjyqësore, dhe për palët e prekura përcaktoi kompensime në të holla, të cilat përputhen me ato që caktohen nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sipas të dhënave, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë ka pranuar 190 kërkesa për vërtetim të shkeljes së të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Gjykata ka vendosur për 80 prej tyre. Prej tyre, 8 janë sjellë si vendime meritore, 24 janë refuzuar si të pabaza, dhe 43 janë hedhur poshtë<sup>484</sup>.

Një parashikim optimist do na jepte të drejtën të supozojmë, se nëse gjatë vitit 2009 mjeti i ri juridik për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, i instaluar me Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit mbi gjykatat (2008), pranohet dhe vlerësohet si efikas nga ana e Gjykatës Evropiane do të rezultonte në uljen graduale të numrit të ankesave të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane<sup>485</sup>. Derisa mos të ndodhë kjo qytetarët e Republikës së Maqedonisë, do të vazhdojnë të drejtohen para Gjykatës në Strasburg me ankesa për shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, pa qenë të obliguar nga neni 35, alinea 1 e Konventës (i cili autorizon qytetarët që t'i drejtohen Gjykatës Evropiane vetëm pasi të kenë konsumuar mjetet juridike nacionale).

E gjithë ajo që theksuam më sipër, udhëzon në konstatimin se në Republikën e Maqedonisë po merren masa të përgjithshme për mbrojtjen e të drejtave të përcaktuara me Konventë, veçanërisht të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, për të cilën sipas përvojës së deritanishme kanë arritur numër më i madh i ankesave para Gjykatës Evropiane nga ana e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

<sup>483</sup> Република Македонија Министерство за правда владин агент на Република Македонија информација за состојбата на предмети против Република Македонија пред Европскиот суд за човекови права за 2008 година. Скопје, Април 2009. Тë dhëna nga interneti:

<http://www.pravda.gov.mk/documents/godisen%20izvestaj%202008.pdf>. Zbritur më: 08.09.2011.

<sup>484</sup> Република Македонија Министерство за правда владин агент на Република Македонија информација за состојбата на предмети против Република Македонија пред Европскиот суд за човекови права за 2008 година. Скопје, април 2009. Тë dhëna nga interneti:

<http://www.pravda.gov.mk/documents/godisen%20izvestaj%202008.pdf>. Zbritur më: 08.09.2011.

<sup>485</sup> Ibid.

**LITERATURA E SHFRYTËZUAR**

1. Asocijacija za evropske integracije (Association for European Integration), “Putokaz” nr. 5, Tema broja – Konvencija o Ljudskim Pravima i Srbija, Septembar / 2007, ISSN 1452-5348, fq. 10, Të dhëna nga interneti: <http://www.fes.rs/pubs/2007/pdf/6.Putokaz%20-%20Konvencija%20o%20Ljudskim%20pravima%20i%20Srbija.pdf>. Zbritur më: 09.09.2011.
2. Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut. Këshilli i Evropës F-67075, Strasbourg Cedex, E drejta për një process të drejtë gjyqësor, Një udhëzues për implementimin e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Nuala Mole dhe Catharina Harby, Të dhëna nga interneti: <http://www.humanrights.coe.int>. Zbritur më: 05.09.2011.
3. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore – 4 nëntor 1950. E miratuar më 4 nëntor 1959 në Romë. Konventa ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1953.
4. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (teksti jozyrtarë, i spastruar – për përdorim intern), Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL), përktheu, përshtati dhe redaktoi Kurtesh Saliu, Tetovë, 2007.
5. Ligji mbi gjykatat, “Gazeta zyrtare e RM” nr. 58/2006 dhe 35/2008, neni 6 parag. 2.
6. Ligji për procedurë penale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.15, 07.03.2005, Tekst i spastruar.
7. Radolović, Aldo, Zaštita prava na suđenje u razumnom roku – Realna mogućnost, (pre)skupa avantura ili utopija,UDK: 342.722, Ur.: 17. siječnja 2008, Pr.: 31. siječnja 2008, Pregledni znanstveni članak, fq. 282, Të dhëna nga interneti: [http://www.pravri.hr/hr/zbornik/v29\\_1/radolovic-29-1-2008.pdf](http://www.pravri.hr/hr/zbornik/v29_1/radolovic-29-1-2008.pdf). Zbritur më 08.09.2011.
8. Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2007.
9. SHBA–Kritika për të drejtat e njeriut në Maqedoni. albanur.net/forum, Të dhëna nga internet: <http://albanur.net/forum/showthread.php?p=2400>. Zbritur më: 07.09.2011.  
Република Македонија Министерство за правда владин агент на Република Македонија информација за состојбата на предмети против Република Македонија пред Европскиот суд за човекови права за 2008 година. Скопје, Април 2009. Të dhëna nga interneti: <http://www.pravda.gov.mk/documents/godisen%20izvestaj%202008.pdf>. Zbritur më: 08.09.2011.